



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **88**

Prishtinë, më 1.10.2012, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Mungoi : Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar të nënshkruar në listën e posaçme për evidentim.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.9.2012,
3. Shqyrtimi i çështjeve aktuale dhe të monitorimit të ligjeve,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.9.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.9.2012.

3. Shqyrtimi i çështjeve aktuale në komision

Kryetari i Komisionit njoftoi Komisionin për gjërat aktuale në monitorimin e Ligjit për Ajrin dhe për Zhurmën ku aktualisht janë duke u diskutuar çështjet financiare për monitorimin e ajrit, për çka është premtuar nga MMPH se do të hiqen ato shpenzime, si dhe në vijim për çështjet si vijon :

- ZRRUM zyrtarisht ka njoftuar se pas miratimit të Ligjit për Mbeturina, tani e tutje do të emërtohet ZRRUK (Zyra rregullator për ujëra e kanalizim), mirëpo kjo çështje duhet të rregullohet edhe me Ligj,
- ZRRUM fton tre deputet për vizitë në Shqipëri prej 9-10 tetor 2012, ndërsa Komisioni vendosi të shkoj edhe një anëtar i stafit bashkë me Nait Hasani-kryetar, Rasim Demiri-nënkryetar dhe Salih Morina-anëtarë. Mbështetja financiare është nga ZRRUM për tre deputet, ndërsa për stafin të kërkohet nga Kryetari i Kuvendit të hiqen shpenzimet.
- U qartësua çështja e kryesuesit të GP për ujëra, mbetet që këtë grup të udhëheq Kryetari i Komisionit,
- **Rasim Demiri** caktoi takimin e grupit punues për ditën e enjte më 4 tetor në njërën pauzë të mbledhjes plenare,
- U kërkua nga Komisioni që grupet punuese të përgatitin amendamentimin e Projektligjeve nëse janë të gatshëm për këtë,
- Kryetari i Komisionit u dakordua me zyrtarin e NDI rreth pagesës së ekspertëve për Projektligjet në procedurë, një ekspert i Rexhistrimit të Bujqësisë do të paguhet nga fondi i Komisionit,
- Dy ministritë dhe APK të ftohen për mbledhjen e radhës për raportin e tremujorit të kaluar bashkë me zjarret që kanë ndodhur, dhe zgjedhjen e çështjes së pyjeve rreth menaxhimit me to, të cilin e ka kërkuar Komisioni nga Qeveria,
- Dy Projektligjet e parqeve nacionale do të procedohen të premtën pasdite për leximin e dytë,
- **Nijazi Idrizi** dhe **Daut Haradinaj** kërkuan qasjen në petitionin e dërguar nga qytetarët e Pejës përkatësisht banorët përreth Bjeshkëve të Nemuna rreth parqeve nacionale, për çka Kryetari tha se në zyrën e tij është Peticioni të cilin mund ta marr secili anëtar, dhe rikujtoi se peticioni në fjalë është i vonshëm, ndërsa për brengat e qytetarëve siç dihet Komisioni me amendament ka hequr ato duke lënë pronat të rregullohen me Ligje të veçanta,
- **Nijazi Idrizi** potencoi kërkesën e tij që Projektet e parqeve është dashur të shqyrtohen bashkërisht me atë të pyjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 14,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani